ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL ZVEÇAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **2026/646-26-7426-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtjen dhe sanimin e rrugëve lokale të fshatrave dhe rrugëve të asfaltuara të qytetit dhe rrugëve" për nevojat e Komunës së Zveçanit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ETEAM SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Milloshevë, Obiliq
(Adresa)

Obiliq — *15050*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/396874 — *N/A*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Drilon Etemi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
eteamshpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

06.11.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Avokat Qëndrim Arifi
(Emri i avokatit)

Rr. "Idriz Gjilani", Llamela 15, Kati 2, Nr. 213, Dardani, Prishtinë.
(Adresa e plotë)

+383 49 875 852
(Numri i Telefonit)

N/A
(Numri i faks-it)

avokatura.ap@gmail.com
(Adresa elektronike)



06.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë – 04.09.2026 *Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve – 24.09.2026* *Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – 08.10.2026* *Kërkesë për rishqyrtim – 12.10.2026* *Vendimi për aprovimin e Kërkesës për Rishqyrtim - 14.10.2026* *Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues pas rivlerësimit – 20.10.2026* *Kërkesë për Rishqyrtim – 26.10.2026* *Vendimi për refuzimin e Kërkesë për Rishqyrtim 29.10.2026.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ x

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ x **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Më 26.10.2026 OE "ETEAM" SH.P.K. ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në pajtim me nenin 108/A të LPP-së. Nëpërmjet Vendimit të datës 29.10.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar në tërësi këtë kërkesë, duke e lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 20.10.2026. Prandaj, brenda afatit ligjor prej dhjetë (10) ditësh të përcaktuar me nenin 109, paragrafi 2 të LPP-së, i drejtohemi Organit Shqyrtues të Prokurimit me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 6 i LPP-së** **Neni 10 i LPP-së** **Neni 7 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së** **Neni 108/A i LPP-së** **Neni 4 i RrPP-së** **çNeni 7.2 dhe 7.4 i RrPP-së]** **Neni 19.11 i RrPP-së** **Neni 27.3 i RrPP-së** **Neni 40.2.1., 40.6, 40.13, i RrPP-së** **Neni 45.17, 45.18 dhe 45.22 i RrPP-së**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Rrjedha e procedurës:

1. ETEAM SH.P.K. më datë 24.09.2026, në përputhje me Njoftimin për Kontratë të Autoritetit Kontraktues (tutje referuar si AK) Kuvendi Komunal Zveçan, ka dorëzuar ofertën e tij për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtjen dhe sanimin e rrugëve lokale të fshatrave dhe rrugëve të asfaltuara të qytetit dhe rrugëve" për nevojat e Komunës së Zveçanit",** me numër të prokurimit: 2026/646-26-7426-2-2-1
2. Në po të njëjtën datë, AK ka publikuar Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve, nga i cili rezulton se për këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar vetëm dy oferta, konkretisht oferta e ETEAM SH.P.K. në vlerë prej 34,280.00 euro dhe oferta e OE Urban O.P në vlerë prej 31,138.00 euro.

3. AK më 08.10.2026 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së me të cilin si fitues shpallë OE-në Urban O.P, ndërsa ofertën tonë e konsideron si të pasuksesshme.

Titulli i kontratës: Mirëmbajtjen dhe sanimin e rrugëve lokale të fshatrave dhe rrugëve të asfaltuara të qytetit dhe rrugëve" për nevojat e Komunës së Zveçanit

Nr. i Prokurimit:	**646**	**26**	**7**	**4**	**2**	**6**	**2**	**2**	**1**

Nr.	**Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës**	**Vlera totale e ofertave[2]**
1.	**Urban O.P., Rr. Selaniku-Mitrovice, 40000, Mitrovice**	**31.138,00 Euro**
2	**ETEAM SH.P.K., Obiliq, 15050, Rruga e Llapit PN, Milloshevë**	**34.280,00 Euro**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Kuvendi Komunal Zveçn **shpërblen** me kontratë **Urban O.P., Rr. Selaniku-Mitrovice, 40000, Mitrovice** në vlerë totale të **ofertës 31138.00 Euro (Tridhjetë e një mijë e njëqind e tridhjetë e tetë euro)**

4. Të pakënaqur me këtë vendim për shkak se OE i rekomanduar ishte qartazi i papërgjegjshëm, më 12.10.2026, pran AK-së parashtrojmë Kërkesë për Rishqyrtim.

5. Më 14.10.2026 AK aprovon në tërësi kërkesën tonë, ashtu që anulon Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 08.10.2026 dhe aktivitetin e prokurimit e kthen në rivlerësim.

6. Më 20.10.2026 AK publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK-së pas rivlerësimit, ku përsëri rekomandohet për kontratë OE Urban O.P.

7. ETEAM ka siguruar qasje në dokumentet e rivlerësimit dhe pas analizimit të tyre rezulton qartë se OE Urban O.P. edhe më tutje mbetet i papërgjegjshëm, dhe në fakt i njëjti pas rivlerësimit është dashur të eliminohet nga gara, ndërsa për kontratë të rekomandohet OE ETEAM SH.P.K.

8. AK më 29.10.2026 e refuzon në tërësi kërkesën tonë për rishqyrtim, ndërsa si pjesë e vendimit të AK-së ishte bashkëngjitur edhe një Letër Standarde drejtuar OE-së së rekomanduar, e cila mbante datën 14.10.2026, ndërsa ETEAM SH.P.K. më 03.11.2026 ka kërkuar qasje në përgjigjet e OE-së së rekomanduar në kërkesat për sqarim të datës 14.10.2026 dhe 15.10.2026, mirëpo AK më 04.11.2026 na ka bashkangjitur përsëri dokumentet që ne i kishim tanimë në posedim, konkretisht "Përgjigjen në Kërkesën për Rishqyrtim" dhe "Marrëveshjen e datës 24.09.2026" në mes të OE-së së rekomanduar dhe Mineral L.L.C. e që kjo nënkupton se OE i rekomanduar nuk është përgjigjur fare në Letrat Standarde të AK-së.

9. ETEAM SH.P.K. i pakënaqur me këtë vendim, i drejtohet Organit Shqyrtues të Prokurimit më këtë ankesë, ndërsa në vazhdim po i parashtrojmë pretendimet tona:

Pretendimi 1: Vendimi i AK-së i datës 29.10.2026 nuk është i arsyetuar dhe nuk i shqyrton pretendimet konkrete të ETEAM SH.P.K.

Në faqen e dytë të vendimit, AK deklaron se Komisioni *"ka paraqitur përgjigjet dhe arsyetimet e tij për secilin pretendim veç e veç".* Përmbajtja e vendimit e kundërshton këtë deklaratë. Vendimi përbëhet nga riprodhimi i plotë i Kërkesës sonë për Rishqyrtim, një përgjigje e përgjithshme mbi natyrën e kërkesave për sqarim, një paragraf i vetëm për eskavatorin dhe dy paragrafë përmbyllës mbi nenet 1, 7 dhe 59 të LPP-së.
Në veçanti, vendimi:

- *nuk thotë asgjë për pretendimin lidhur me "Senzues i asfaltit".*
- *nuk thotë nëse OE Urban O.P. është përgjigjur fare në kërkesën për sqarim të datës 15.10.2026 lidhur me pompën e ujit, as çfarë ka dorëzuar dhe as pse ajo përgjigje e dëshmon kërkesën "3hp, diesel".*
- *nuk e adreson faktin, të ngritur shprehimisht nga ETEAM, se OE i rekomanduar pretendon se marrëveshjen e nënshkruar me Mineral L.L.C. e ka pranuar me e-mail më 22.09.2026, ndërsa marrëveshja mban datën 24.09.2026.*
- *nuk identifikon se cilin dokument e ka pranuar si dëshmi për kompresorin dhe për eskavatorin, as pse ai dokument plotëson kërkesat e Aneksit 7.*

Sipas nenit 108/A, paragrafët 9 dhe 12 të LPP-së, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim *"do të arsyetohet"* dhe vendimet *"duhet të jenë të arsyetuara".* Arsyetimi nënkupton përgjigje konkrete në pretendime konkrete, jo formulime shabllone si *"dokumentet janë shqyrtuar"* apo *"vlerësimi nuk është mbështetur në një dokument të vetëm"*. Një vendim që nuk e tregon bazën faktike për secilin pretendim e privon operatorin ekonomik nga mundësia që ta kundërshtojë atë në mënyrë efektive dhe cenon parimin e transparencës sipas nenit 7.1 të LPP-së.

Prandaj, vendimi i AK-së i datës 29.10.2026 është nxjerrë në shkelje të nenit 108/A.9 dhe 108/A.12 të LPP-së dhe si i tillë duhet të anulohet.

Pretendimi 2: AK aprovon Kërkesën tonë paraprake për Rishqyrtim (12.10.2026), mirëpo rivlerësimin nuk e ka kryer në përputhje me kërkesat ligjore

AK pretendon se gjatë rivlerësimit *"operatorit ekonomik i është kërkuar vetëm sqarimi dhe verifikimi i dokumentacionit"* dhe se "*kjo kërkesë nuk ka pasur për qëllim plotësimin e ofertës me dokumentacion të ri"*. Gjithashtu pretendon se sqarime janë kërkuar për të pesë

pikat e Kërkesës sonë të parë për Rishqyrtim, përfshirë "Senzues i asfaltit". Këto arsyetime të AK-së nuk qëndrojnë, ndërsa arsyet po i bashkëngjisim në vazhdim:

Së pari, Letra standarde e AK-së për sqarime e kundërshton arsyetimin e saj. Në kërkesën për sqarim të datës 14.10.2026, të bashkëngjitur nga vetë AK në vendim, AK për kompresorin shkruan: *"Nëse dispononi faturën përkatëse ose dokumente të tjera mbështetëse të lejueshme sipas legjislacionit të prokurimit publik"*. Të njëjtën ftesë e përsërit për eskavatorin: *"Pas sjelljes së dokumentacionit që e vërteton se pajisja në fjalë është në pronësinë e OE ... Nëse dispononi faturën përkatëse ose dokumente të tjera mbështetëse"*. Kjo nuk është kërkesë për sqarimin e një dokumenti ekzistues në ofertë. Është ftesë e hapur për të dorëzuar dokumente të reja, në vend të atyre që ETEAM i kishte kontestuar me sukses dhe që AK i kishte pranuar si të kontestueshme kur e aprovoi Kërkesën për Rishqyrtim.

Pastaj, për "Senzues i asfaltit" NUK ËSHTË KËRKUAR ASNJË SQARIM. Letra e datës 14.10.2026, ashtu siç e ka paraqitur AK, përmban pikat 1, 2, 3 dhe 5. Pika 4, që sipas listës së AK-së do të duhej të ishte senzuesi i asfaltit, nuk ekziston në letër. Pra, pohimi i AK-së se ka kërkuar sqarime për të pesë pretendimet nuk vërtetohet nga dokumenti i saj.

Tutje, sqarimet janë përsëritur për të njëjtat çështje. Për pompën e ujit AK ka kërkuar sqarim më 14.10.2026. Pasi OE i rekomanduar ka dorëzuar një sqarim kinse nga *"kompania e Ndërtimit"*, AK më 15.10.2026 ka konstatuar se *"në sqarimin e paraqitur nuk është specifikuar se cilës faturë i referohet ky sqarim"* dhe i ka dhënë mundësi të re. Për marrëveshjen me Mineral L.L.C., AK në pikën 5 të letrës së 14.10.2026 shkruan se *"edhe njëherë kërkojmë"* sqarim, pas një sqarimi të mëparshëm në vlerësimin fillestar. Sipas nenit 45.22 të RrPP-së, sqarimet *"nuk duhet në asnjë rrethanë të negociohen"*, ndërsa neni 59.5 i LPP-së ndalon çdo komunikim, diskutim ose negociatë përtej sqarimit të lejuar. Dhënia e mundësive të njëpasnjëshme një tenderuesi derisa ai të prodhojë dëshminë e duhur është pikërisht negocim i ndaluar dhe e vendos ETEAM në pozitë të pabarabartë, në kundërshtim me nenin 7.1 të LPP-së.

Gjithashtu është tejet shqetësuese që komunikimi sipas të gjitha gjasave është bërë jashtë platformës elektronike. Letra Standarde e datës 14.10.2026 dhe e datës 15.10.2026 kërkon që përgjigjet të dorëzohen *"në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e faks-it +383 20034835 apo në e-mailin valeza.jusufi@rks-gov.net"*. Neni 40.8 i RrPP-së kërkon që kërkesa për sqarim dhe përgjigjja *"duhet të bëhen me shkrim përmes platformës elektronike"*, ndërsa neni 45.30 kërkon që verifikimi i kualifikimeve të bëhet përmes Letrës Standarde B45 *"përmes platformës elektronike"*. Kjo nuk është shkelje e hapur e legjislacionit, sepse vetëm platforma e regjistron në mënyrë objektive kohën dhe përmbajtjen e përgjigjes.

Sipas nenit 40.2.1 të RrPP-së, rivlerësimi pas aprovimit të kërkesës për rishqyrtim bëhet *"për të korrigjuar parregullsitë e mundshme ligjore"*. Në vend që të eliminonte ofertën që nuk i plotësonte kërkesat, AK ka përdorur rivlerësimin për t'i mundësuar OE-së së rekomanduar plotësimin e mangësive të ofertës.

Pretendimi 3: Nuk na është ofruar asnjë dokument zyrtar që dëshmon se OE i rekomanduar është përgjigjur në kërkesat për sqarim të datave 14.10.2026 dhe 15.10.2026, prandaj oferta e tij duhej të refuzohej sipas nenit 45.22 të RrPP-së

Gjatë rivlerësimit, AK i ka dërguar OE Urban O.P. dy Letra Standarde për sqarim, konkretisht një më datë 14.10.2026, dhe tjetrën më datë 15.10.2026.

Letrat Standarde kërkojnë që përgjigjet të jepen "*me shkrim"* dhe *"brenda 3 (tri) ditë nga data e kësaj kërkese".* Ajo paralajmëron shprehimisht: *"Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet."*

Në dokumentet e rivlerësimit të ofruara nga AK për ETEAM pas Njoftimit të datës 20.10.2026 nuk ka asnjë përgjigje të OE-së së rekomanduar ndaj këtyre kërkesave.
Vendimi i datës 29.10.2026 e bashkëngjit letrën e 14.10.2026 si "Provë". Megjithatë, nuk bashkëngjit asnjë përgjigje të OE-së dhe nuk tregon se kur, si dhe me çfarë përmbajtjeje është pranuar ndonjë përgjigje.

Më 03.11.2026 ETEAM i ka kërkuar AK-së me shkrim pikërisht përgjigjet e OE-së së rekomanduar ndaj Letrave Standarde të datës 14.10.2026 dhe 15.10.2026. Më 04.11.2026 AK ka dërguar vetëm "Kundërpërgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim" dhe marrëveshjen me Mineral L.L.C. të datës 24.09.2026. Asnjë përgjigje ndaj kërkesave për sqarim nuk është dërguar.

Sipas nenit 45.22 të RrPP-së, *"Nëse nuk ka përgjigje nga Operatori përkatës ekonomik, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderuesin".* Sipas nenit 59.2 të LPP-së, sqarimi jepet *"me shkrim".* Sipas nenit 72.1 të LPP-së, dokumentacioni shtesë dorëzohet *"brenda një afati të caktuar kohor".* Sipas nenit 40.8 të RrPP-së, kërkesa për sqarim dhe përgjigjja *"duhet të bëhen me shkrim përmes platformës elektronike"*. Sipas nenit 10.1 dhe 10.2 të LPP-së, AK mban në evidencë të gjitha dokumentet e pranuara gjatë aktivitetit të prokurimit.

Përgjigjja ndaj kërkesës për sqarim është dokument zyrtar me datë dhe duhet të ekzistojë në dosje. Ajo është dokument i shkruar, me datë pranimi, të cilin AK duhet ta ruajë në evidencën e aktivitetit sipas nenit 10.2 të LPP-së. Sipas nenit 40.8 të RrPP-së, ajo duhet të jetë e regjistruar në platformën elektronike. AK nuk e ka paraqitur një dokument të tillë në dokumentet e rivlerësimit, në vendimin e saj dhe as kur ETEAM ia ka kërkuar shprehimisht.

Prandaj, nuk është vërtetuar se OE i rekomanduar është përgjigjur me shkrim dhe brenda afatit. Pa këtë, AK nuk kishte bazë për të konstatuar plotësimin e kërkesave për të cilat vetë kishte kërkuar sqarim.

Gjithashtu duhet theksuar se *"Kundërpërgjigja ndaj kërkesës për rishqyrtim"* është parashtresë e palës së interesuar në procedurën e rishqyrtimit sipas nenit 108/A të LPP-së, e drejtuar kundër kërkesës së ETEAM. Ajo nuk është përgjigje ndaj pyetjeve të AK-së sipas nenit 59.2 të LPP-së dhe nenit 45.22 të RrPP-së, e dorëzuar përmes platformës sipas nenit 40.8 të RrPP-së. Kur ETEAM kërkoi përgjigjet ndaj sqarimeve, AK dërgoi pikërisht këtë parashtresë. Kjo tregon se AK nuk disponon përgjigje ndaj kërkesave për sqarim.


Meqenëse nuk ekziston asnjë dokument zyrtar që dëshmon përgjigjen me shkrim dhe brenda afatit ndaj kërkesave të 14.10.2026 dhe 15.10.2026, AK duhej ta refuzonte ofertën e OE Urban O.P. sipas nenit 45.22 të RrPP-së, e jo ta rekomandonte për kontratë.

Pretendimi 4: OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesën për "Kompresor ajri dhe agregat"

AK në kuadër të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër tjerash në Aneks 7 ka kërkuar edhe: **"Kompresor ajri dhe agregat"** sasia 1, ndërsa po në Aneks 7, AK taksativisht ka kërkuar që për pajisjet që ofrohen të dëshmohet në mënyrë të qartë posedimi apo pronësia e tyre, konkretisht AK tek aneks 7 thekosn se:

N.R.	Përshkrimi i pajisjes	Sasia minimale (copë)	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për pajisjet Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit valide, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje ! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

OE i rekomanduar për të dëshmuar se përmbush këtë kërkesë, në ofertën e tij ka dorëzuar një profaturë. Fillimisht duhet saktësuar se profatura në asnjë formë nuk nënkupton që fillimisht është përfunduar shitblerja, e lëre të dëshmoj se OE i rekomanduar e ka tanimë në posedim pajisjen.



UNIVERZAL
REMZI GECAJ B.I.

NU: 810364331 NF: 600239421 TVSH: 330285933
TEB-2027000086980886
BPB-1305001002676131,
Adresa Rr: Ulqinit Mitrovicë
Tel 049/876-525 049/876-977

Profature
119436

Data
10-Jul-26

Afati i pageses

Menyra e pageses
BPB 1305001002676131

Bleresi URBAN O.P -
Adresa Mitrovicë
Nr Biznesit 811279026
Nr Fiskal 811279026
Nr TVSH
Tel:

Nr	Kodi	Pershkrimi	S/N	Njesia	Sasia	Rabat	Cmimi/ni	Gjithsej
1	4197	47526 Gjenerator me karburant 10.6kva FF Group *		Cope	1	0 %	1360.00	1,360.000
2	12078	Kompresor ajri 100 litra Airclassic 451/100/10 *		Cope	1	0 %	780.00	780.000

Borxhi paraprak € 6,815.50
Kjo fature € 2,140.00
Per pagese € 8,955.50
Pagoi € 0.00
Borxh € 8,955.50

TVSH 8 % €0.00
TVSH 18 % €326.44

Pa TVSH €1,813.56
TVSH €326.44
Gjithsej €2,140.00

Shitesi:

Pranoi:

Vrejtje: Ju lutem shenoni nr e fatures me rastin e pageses ne Banke

URBAN O.P

pdfelement

Rrjedhimisht, OE i rekomanduar ka dështuar të dëshmojë posedimin e pajisjes sipas kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, pasi që profatura nuk përbën dokument dëshmues të pronësisë së pajisjes, por vetëm dokument paraprak që pasqyron një ofertim ose transaksion të planifikuar. Rrjedhimisht, pranimi i saj si dëshmi e posedimit të pajisjes është në kundërshtim me kërkesën e qartë të Dosjes së Tenderit, sipas së cilës pronësia duhet të dëshmohet përmes faturës, DUD-it apo dokumentit tjetër përkatës, ndërsa në mungesë të pronësisë kërkohet marrëveshje e vlefshme për marrjen me qira të pajisjes, e lidhur posaçërisht për projektin.

Pas rivlerësimit:

Gjatë sigurimit të qasjes së dokumenteve të procesit të rivlerësimit konstatohet se AK më 14.10.2026 ka kërkuar sqarime shtesë për këtë pretendim tonin ankimor, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dokument i cili dëshmon se OE i rekomanduar ka ofruar përgjigje. Përkundër kësaj, AK na ka dërguar një dokument të titulluar: "Kundërpërgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim", ku OE i rekomanduar kundërshton Kërkesën për Rishqyrtim të OE ETEAM SH.P.K., duke tentuar të ofroj sqarime se pse pretendimet tona nuk qëndrojnë.


Në kuadër të kësaj shkrese OE i rekomanduar ka ofruar si dëshmi faturën e rregullt duke dëshmuar se pretendimi ynë është në tërësi si i bazuar sepse profatura nuk është një dokument valid që dëshmon posedimin e pajisjes. Ndërsa sa i përket faturës së re të ofruar nga OE i rekomanduar, vlerësojmë se kjo është e papranueshme sepse përbën ndryshim

material të ndaluar me nenin 59.4 të LPP-së. Dhe nëse do pranohej një ndryshim i tillë, atëherë operatorët tjerë në garë do t'i vendoste në pozitë të pabarabartë, gjë që shkelë prarimin elementar të LPP-së të proklamuar me nenin 7. Sepse në këtë rast kemi të bëjmë me zëvendësim të dokumentit, e jo me sqarime shtesë të një dokumenti ekzistues.

Prandaj, edhe pas rivlerësimit AK, përkatësisht Komisioni i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke i mundësuar një operatori të papërgjegjshëm të rekomandohet për kontratë.

Pretendimi 5: OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesën për "Pompë e ujit 3hp, diesel"

AK në kuadër të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër tjerash në Aneks 7 ka kërkuar edhe: **"Pompë e ujit 3hp, diesel"**, sasia 1. OE i rekomanduar ka dorëzuar një faturë për pompë thithëse dhe hedhëse e ujit pa dëshmuar atë se e njëjta është 3hp dhe diesel.



N.P.T BAJRA
Rr Marigona Residenc,PN
Preoc, Gracanice
10500, Kosove
Nr. Unik Identifikues: 810509391
Nr.Biznesit: 70286644
Nr.Tvsh 330148347

B A J R A

'atura Për: EURONDERTIMI SH.P.K.
Ir. unik/fiskal: 810108995 /
Ir. biznes/tvsh: /
ontakti: 049/100955
dresa: Mitrovicë, Azem Behrami
40000, MITROVICË - KS

Fatura
401-210-001-26
Vlera e mbetur: 785.80
Shtateqind e tetedhjete e pese. Tetedhjete

Njësia Org.	Data e faturës	Afati për pagesë	Referenca	Referenti i juaj	Kushtet
Depoja Kryesore	12.06.2026	22.06.2026	*		NET 10

Nr	Shifra	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Çmimi pa Tvsh	Rabati (%)	Tvsh %	Çmimi me rabat	Çmimi shitës	Vlera shitëse
1	4348	Pomp thithese dhe hedhese e ujit WP 900	1.00	CP	593.22	0.00	18.00	593.22	700.00	700.00
2	4522	Gyp i valzuar 4"(102) i gjelbert 25m	6.00	M	12.12	0.00	18.00	12.12	14.30	85.80

Pas kalimit te afatit te pageses aplikohen ndeshkimet

Vlera pa tvsh:		665.93 EUR
Tvsh:	18.00%	119.87 EUR
Vlera për pagesë:		785.80 EUR

Pra, ashtu siç shihet qartë, në faturën e dorëzuar nuk janë të specifikuara karakteristikat teknike thelbësore të pompës së ujit, përkatësisht fuqia prej 3 hp dhe lloji i motorit (diesel). Për rrjedhojë, nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konstatohet në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme se pajisja e ofruar i përmbush kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Pas rivlerësimit:


AK lidhur me këtë pretendim tonin ankimor më 14.10.2026 dhe 15.10.2026 ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar, mirëpo ne nuk kemi asnjë dëshmi se i njëjti ka ofruar sqarime shtesë për këtë pajisje. Heshtja ndaj sqarimeve të kërkuara nga AK automatikisht përbënë arsye për eliminim, kjo saktësohet qartë në nenin 45.22 të RrPP-së ku theksohet se: "*Sqarime të tilla nuk duhet në asnjë rrethanë të negociohen. Nëse nuk ka përgjigje nga Operatori përkatës ekonomik, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderuesin".*

OE i rekomanduar në të ashtuquajturën: "Kundërpërgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim", veç se e pranon mos përputhjen e pajisjes së ofruar me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues as pas rivlerësimit nuk ka pasur bazë për të konstatuar përmbushjen e kësaj kërkese dhe, si pasojë, nuk është dashur ta rekomandojë për dhënie të kontratës operatorin ekonomik Urban O.P.

Pretendimi 6: OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar që ka marrëveshje për posedimin e pajisjes "Eskavator me zingjir gome"

AK në kuadër të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër tjerash në Aneks 7 ka kërkuar edhe: **"Eskavator me zingjir gome",** sasia 1. OE i rekomanduar për kontratë lidhur me këtë pajisje ka ofruar një DUD doganor, ku shihet qartë se kjo pajisje është në pronësi të subjektit "N.T.P. Ferizi", mirëpo nuk ka bashkëngjitur asnjë marrëveshje për shfrytëzimin e kësaj pajisje, ashtu siç ka qenë kërkesë e Dosjes së Tenderit.


8 Marrësi / Importuesi
N.T.P. "FERIZI"
GLLOGOC, LIPJAN
Nr 600338538
9 Personi përgjegjës financiar
N.T.P. "FERIZI"
GLLOGOC, LIPJAN
Nr 600338538
10 Vend. XK nga
11 Vendi i XS cty.
12 Detajet e vlerës 800.00
13 P.P.B 1
14 Deklaruesi
N.P. "BINA - SHPED"
NA
Nr 600105622
15 Vendi dërgues/eksportues ZVICRRA
15 V.E. Kodi a CH b
17 V.D. Rajoni a XK b
16 Vendi origjinës JAPANI
17 Vendi i destinacionit KOSOVA
18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në nisje/arritje VR044GZ AA684VR XS
19 no
20 Kushtet e dërgesës EXW Kreuztal-DE
21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon kufirin VR044GZ AA684VR XS
22 Valuta dhe shuma e përgjithshme CHF 6,000.00
23 Kursi i këmbimit 0.8631852
24 Lloji i 1 1 transak.c
25 Lloji transportit 30 në kufi
26 Lloji transportit 30 Transport
27 Vendi ngarkimit/shkarkimit
28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e pagesës
29 Zyra doganore hyrëse/dalëse 3041 PKK DHEU I BARDHË
30 Lokacioni i mallrave
Shenjat dhe numrat - Nr i kontenierit - Numri dhe lloji
Shenja & nr
I pakove me 2 luge
Numri dhe 1 NG
Lloji Pa paketim
Makineritë te tjera me rrotullim të superstrukturës 360°
Eskavator i përdorur,Marka:Hitachi ZX75,Tipi:EX75US-7
Ngjyra:E verdhe,V.prodhimi 2002
Nr shasis:HCM1CC00A00031028
32 Artikulli 1 No.
33 Numri tarifor 84295290 00
34 Kodi origjinës a JP b
35 Pesha bruto (kg) 8,800.00
36 Preferenca
37 Procedura 4000 000
38 Pesha Neto (kg) 8,800.00
39 Kuota
40 Dokumenti paraprak/dok. përmbledhës
S/L 1
41 Njesia plotësuese
42 Çmimi për njësi
43 M.V.

Prandaj, mungesa e një dëshmie të tillë, nënkupton se OE i rekomanduar nuk e përmbush këtë kërkesë dhe në asnjë formë nuk e justifikon vendimin e AK-së që opertatori Urban O.P të rekomandohet për kontratë. Rrjedhimisht AK në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe

RrPP-së, ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe i cili në fakt është dashur të eliminohet si OE i papërgjegjshëm.

Pas rivlerësimit:

AK me Letrën Standarde të datës 14.10.2026 ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar, mirëpo neve nuk na ka ofruar asnjë dokument që dëshmon se OE i rekomanduar i është përgjigjur formalisht AK-së. Ndërsa nga dokumenti "Kundërpërgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim" edhe vet OE i rekomanduar e ka pranuar se DUD-i i bashkëngjitur në ofertë nuk e dëshmon pronësinë apo posedimin real, sepse të njëjtën pajisje e ka blerë qysh në vitin 2018. Pranimi eventual tani i një fature blerje të cilën OE i rekomanduar e ka pasur në posedim që nga viti 2018, mirëpo i njëjti ka vendosur që ta vendos një DUD doganor që nuk dëshmon pronësinë dhe i cili i ka paraprirë kësaj fature padyshim se përbënë trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomik dhe padyshim se përbënë ndryshim material të kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Pra, kemi të bëjmë me zëvendësim të dokumentit, e jo me sqarime shtesë të një dokumenti ekzistues.

Prandaj, oferta e OE-së së rekomanduar është dashur të eliminohet.

Pretendimi 7: OE i rekomanduar nuk ka ofruar dëshmi që plotëson kërkesën "Senzues i asfaltit"

AK në kuadër të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër tjerash në Aneks 7 ka kërkuar edhe: **"Senzues i asfaltit"**, sasia 1. Lidhur me plotësimin e kësaj kërkese OE i rekomanduar ka ofruar vetëm një katalog, i cili në asnjë formë nuk dëshmon se ky OE ka në pronësi, posedim apo shfrytëzim një pajisje të tillë të kërkuar me Dosje të Tenderit.

Pas rivlerësimit:

AK gjatë rivlerësimit me Letren Standarde të datës 14.10.2026 dhe të datës 15.10.2026 NUK KA KËRKUAR ASNJË SQARIM lidhur me këtë pajisje të veçantë të Dosjes së Tenderit, ndërsa OE i rekomanduar përsëri në të ashtuquajturën "Kundërpërgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim", ka pretenduar se këtë pajisje e ka të inkorporuar në finisher.

AK, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të veçantë kërkesën për **"Senzues i asfaltit – sasia 1",** duke e kërkuar si pajisje të veçantë. Për rrjedhojë, përmbushja e kërkesës për finisher nuk mund të konsiderohet automatikisht edhe si përmbushje e kërkesës së veçantë për senzuesin e asfaltit. Fakti që OE i rekomanduar pretendon se senzuesi është i inkorporuar në finisher nuk mjafton për të dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkese, veçanërisht kur një pajisje e tillë është kërkuar shprehimisht dhe në mënyrë të ndarë nga AK.

Për më tepër, OE i rekomanduar nuk ka arritur të argumentojë dhe dëshmojë në mënyrë të verifikueshme se finisheri konkret i ofruar prej tij posedon të integruar senzuesin e asfaltit të kërkuar nga Dosja e Tenderit. Pra, nuk mjafton një deklarim i përgjithshëm se senzuesi është pjesë përbërëse e finisherit.

Prandaj, është tejet shqetësuese se i AK ka rekomanduar për kontratë këtë OE, përkundër këtyre mangësive të dëshmuara.

Pretendimi 8: Dyshimet lidhur me kohën e krijimit të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe dështimi për të dëshmuar sigurimin e tri pajisjeve të kërkuara

OE i rekomanduar në ofertën e tij ka bashkëngjitur një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Mineral L.L.C. lidhur me pajisjet:

- ***Makinë për spërkatje të emulzionit***
- ***Bulldozher me zingjir***
- ***Spërkatëse për bitumen dhe emulsion.***

Kjo marrëveshje është e datës 13.07.2026, ndërsa marrëveshja në fjalë ka të bëjë me një aktivitet krejtësisht tjetër, konkretisht aktivitetin me titull: "Rregullimi i rrugës Nezir Zasella" në Mitrovicën Veriore , me numër të prokurimit 647-26-4540-5-2-1. Pra lidhur me një aktivitet të inicuar nga një autoritet tjetër kontraktues.

Për më tepër, pas kërkesës për sqarime nga AK, OE i rekomanduar ka dorëzuar një marrëveshje tjetër bashkëpunimi, e cila mban datën 24.09.2026. Edhe pse kjo datë është brenda afatit për dorëzimin e ofertave, fakti se marrëveshja është paraqitur vetëm pas kërkesës për sqarime ngre çështjen thelbësore nëse dokumenti ka ekzistuar realisht në kohën e dorëzimit të ofertës apo është krijuar vetëm pas kësaj kërkese. Në mungesë të dëshmive objektive që mundësojnë verifikimin e kohës së krijimit dhe ekzistimit të saj, AK nuk mund të mbështetet vetëm në datën e shënuar në dokument për të konstatuar se OE i rekomanduar e ka përmbushur këtë kërkesë në kohën e duhur.

Në këtë drejtim, AK është dashur të verifikojë në mënyrë të kujdesshme nëse marrëveshja e dorëzuar pas kërkesës për sqarime sqaron një gjendje faktike që ka ekzistuar në kohën e dorëzimit të ofertës apo, përkundrazi, paraqet një dokument të krijuar më vonë për të plotësuar një kërkesë të cilën OE nuk e kishte dëshmuar me ofertën fillestare. Pranimi i saj pa një verifikim të tillë rrezikon të cenojë trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, duke krijuar mundësinë që mangësitë në dokumentacionin e ofertës të plotësohen pas afatit, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe konkurrencës së drejtë.

Pas rivlerësimit:

AK gjatë rivlerësimit nëpërmjet Letreës Standarde të datës 14.10.2026 ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar, mirëpo ne nuk kemi asnjë dëshmi që OE i është përgjigjur asaj kërkese. Ndërsa tendencat për të vërtetuar kinse të kundërtën e pretendimit tonë nga OE i rekomanduar nëpërmjet "Kundërpërgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim", vetëm sa e ka bërë edhe më të sigurt bindjen tonë për manipulim, konkretisht për mos plotësim të kësaj kërkese.

OE i rekomanduar pretendon se ka zhvilluar komunikime elektronike me kompaninë Mineral L.L.C., duke potencuar dhe faktuar se kinse këtë marrëveshje nëpërmjet e-mailit e ka pranuar më 22.09.2026.

Fillimisht duhet theksuar se këto komunikime në asnjë formë nuk dëshmojnë se kanë të bëjnë me marrëveshjen e kontestuar sepse dokumentet e bashkëngjitura në e-mail nuk kanë titull identifikues si dhe ajo më e rëndësishmja OE i rekomanduar këto marrëveshje të nënshkruara i ka pranuar kinse më 22.09.2026, ndërsa data në marrëveshjen e kontestuar është 24.09.2026.

AK në Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim pas rivlerësimit lidhur me këtë çështje ka theksuar se: *"AK konstaton se marrëveshja "mban datë para hapjes së ofertave", se pretendimet për datën e krijimit "duhet të mbështeten në prova konkrete ... dhe jo vetëm në dyshime" dhe se Komisioni "ka bërë dallimin ndërmjet datës së krijimit të dokumenteve dhe datës së paraqitjes së tyre".*

Duhet theksuar se barra e verifikimit objektiv nuk mund t'i kalohet ankuesit. Sipas nenit 72.3 të LPP-së, një dokument i dorëzuar pas afatit mund të pranohet vetëm nëse ekzistenca e tij para afatit *"mund të verifikohet në mënyrë objektive".* Kjo është kusht për pranimin e dokumentit, të cilin duhet ta plotësojë ai që e paraqet dhe ta verifikojë AK. Nuk është barrë e ankuesit që të provojë të kundërtën, sidomos kur ankuesi nuk ka qasje në dokumentet e brendshme të OE-së së rekomanduar. Data e shënuar nga vetë palët në një marrëveshje private nuk është verifikim objektiv.

Gjithashtu lidhur me këtë pretendim tonin ankimor, AK nuk ka verifikuar, por ka kërkuar vetëdeklarim. Në pikën 5 të Letrës së datës 14.10.2026, AK i kërkon OE-së së rekomanduar vetëm *"të sqaroj se marrëveshja në fjalë është bërë para aplikimit*". Ky është vetëdeklarim i palës së interesuar, jo verifikim objektiv.

Përfundimisht përveç ashtu siç u theksua më lartë, Komisioni i rivlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59 paragrafi 1 të LPP-së, pasi të njëjtit janë të obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe Dosjen e Tenderit. Bazuar në nein 27, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3 të RrPP-së në mënyrë shumë të qartë thuhet se: *"Nëse kriteri "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuara. Nëse kriteri është 'tenderi ekonomikisht më i favorshëm', kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante".* Përkundër se ne plotësojmë të gjitha kërkesat dhe jemi OE i vetëm i përgjegjshëm, AK na ka shpallë OE të pasuksesshëm, duke rekomanduar për kontratë një OE i cili qartazi nuk ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe si i tillë është i papërgjegjshëm.

Komisioni i rivlerësimit ka shkelur në mënyrë flagrante nenin 40, paragrafi 6 i RrPP-së, kur ka rekomanduar për kontratë OE-në Urban O.P. Bazuar në këtë dispozitë, në mënyrë taksative potencohet se: *"Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:*

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit".

OE Urban O.P, ashtu sic u theksua nga pretendimi 4-8, përkundër se nuk ka përmbushur disa kërkesa lidhur me kapacitetin teknik/profesional, AK e ka rekomanduar për kontratë, ndërsa ofertën tonë (si e vetmja ofertë e përgjegjshme) e shpallë padrejtësisht si të pasuksesshme.

Gjithashtu Komisioni i rivlerësimit nuk ka respektuar nenin 40 të RrPP-së, konkretisht paragrafin 1, i cili kërkon që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. Pastaj paragrafin 13 i cili saktëson se: *"Komisioni vlerësues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit"*

Gjithashtu Komisioni i rivlerësimit të AK-së ka shkelë edhe nenin 7 të LPP-së, ku në paragrafin 1 të nenit 7 parashihet qartë se: *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente.* Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së parasheh që: *"Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse",* mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Përtej këtyre, AK nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Andaj, mbi bazën e asaj që u theksua më lartë, Organit Shqyrtues të Prokurimit i propozojmë që të marrë këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e OE "ETEAM SH.P.K"

II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 20.10.2026, ashtu që lënda kthehet në **RIVLERËSIM** duke u rekomanduar për kontratë OE ETEAM SH.P.K si OE i përgjegjshëm dhe me çmimin më të lirë.

III. **DETYROHET** AK që ankuesit OE "ETEAM SH.P.K." t'ia mbulojë shpenzimet e procedurës.

IV. Meqë ankesa ishte e bazuar, OE "ETEAM SH.P.K." i kthehen mjetet e depozituara në emër të ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

ETEAM SH.P.K., deri në këtë fazë të procedurës i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme të cilat konsistojnë në përgatitjen e aplikimit për tender, përgatitjen e mjeteve juridike për apelimin e vendimeve të kundërligjshme të AK-së. Andaj, në rast se OSHP nuk e kthen ligjshmërinë në këtë aktivitet, dëmet do të marrin dimension

të paparashikueshëm për shkak të privimit nga e drejta për shpërblim me kontratë, të cilat do të detyrohet AK t'i kompensoj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*